



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA
GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS MALISHEVË

Numri i lëndës: 2023:301429

Datë: 21.12.2024

Numri i dokumentit: 06636246

C.nr.890/23

Gjykata Themelore Gjakovë - Dega Malishevë, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, me gjyqtarin Petrit Curri, si dhe me Zyrtarin e Lartë për Bashkëpunim Profesional Visar Morina në çështjen juridike të paditësit F.K.e punësuar në SHFMU “K.R.” në fshatin K., Komuna e Malishevës, të cilën me autorizim i përfaqëson Av. Fitim Gashi nga Prishtina, ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit, të cilën me autorizim e përfaqëson avokati publik komunal Mujë Sahitaj, sipas bazës juridike kompensim të borxhit në emër të licencimit/kualifikimit, jashtë seancës gjyqësore, me datën 21.12.2024 muar këtë:

A K T G J Y K I M
PA SHQYRTIM KRYESOR TË ÇËSHTJES

I. APROVOHET pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia paditësit F.K.e punësuar në SHFMU “K.R.” në fshatin K., Komuna e Malishevës.

II. DETYROHET e paditura Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit që paditësit F.K.në emër të kompensimit të kualifikimit/licencimit, t’ua paguaj mbi pagën bazë (paga bazë 231.66 € * 27% i pagës bazë (62.54 € - 32.08 diferencë e paguar në page = 30.46 €) për periudhën nga data 01.02.2021 deri me datë 06.02.2023 x 24 muaj gjithsej 24* 30.46 = **731.04 euro**, të gjitha me kamatë ligjore prej 8% që nga dita e paraqitjes së padisë dt. 07.12.2023, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, pas pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të dhunshëm.

III. REFUZOHET si e pa bazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë e kërkuar në emër të kualifikimit, mbi pagën bazë prej 231.60 euro.

IV. DETYROHET e paditura që paditësit t’ia kompensojë shpenzimet e procedurës dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës shumën prej 20.00 euro.

A r s y e t i m

Paditësi F.K.e punësuar në SHFMU “K.R.” në fshatin K., Komuna e Malishevës, përmes të autorizuarit të tij Av. Fitim Gashi nga Prishtina, në këtë gjykatë ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Malishevës – Drejtoria e Arsimit sipas bazës juridike kompensim i borgjtit në emër të licencimit/kualifikimit. Sipas padisë paditësi është punëtor i arsimit në SHFMU “K.R.” në fshatin K., pasi që e paditura deri në ushtrimin e kësaj padie nuk i ka kompenzuar për kualifikim, atëherë paditësi kërkon nga gjykata që pas administrimit të provave të aprovohet

si e bazuar padia e paditësit dhe të detyrohet e paditura që në emër të kualifikimit paditësit t'ia kompenzojë në vlerën prej 27 % (113.67-32.08, e realizon) =81.59 të pagës bazë 421.00 për periudhën 01.02.2021 deri më datë 06.02.2023 për 24 muaj x 81.59 euro në shumën totale prej 1,956.16 euro, me kamatë ligjore prej 8% nga momenti i dorëzimit të padisë e deri në pagesën definitive.

Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe atë për parashtrimin e padisë t'ia paguaj shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës shumën prej 20 euro.

Gjykata pas shqyrtimit paraprak të padisë së paditësit e ka njoftuar të paditurën me aktvendim mbi dhënien e përgjigjes në padi.

E paditura përmes përgjigjes së sajë në padi ndër të tjera ka theksuar se kërkesa e parashtruar nga paditësi ne ketë rast e lidhur më pagesën e kualifikimit nuk ka asnjë bazë ligjore ne kontratën kolektive, për faktin se baze te kontratës së mësimdhënësve kualifikimi i paguhet çdo mësimdhënësi që është paraqitur ne kontratën e punës gradimi mbi pagën baze. Kontratën Kolektive te Arsimit ne Kosovë të datës 18.04.2017, ne veçanti nenin 7 [Licencimi] ku paditësit pretendon se i takon e drejta e kompensimit e të ardhurave nga marrëdhënia e punës mbi bazën e kualifikimit, kjo dispozitë përcakton se me licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karriere dhe zhvillim profesional ne baze te legjislacionit te punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shpëputje nga puna sipas legjislacionit te arsimit ne fuqi dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: 1.3. Mësimdhënës me diplome fakulteti tri dhe katër vjeçare 27⁰/0 të pagës baze, padia është në tërësi e pabazuar dispozitat e këtij neni nuk ka karakter imperativ dhe si e tillë nuk e obligon asnjërin nga subjektet e përfshira ne procesin e licencimit, por kjo dispozitës se lartcekur shihet qarte që qëllimi i saj është ngritja kualitative për mësimdhënësit e angazhuar dhe assesi detyrimi për kompensim. Ky kompensim nuk është i përfshirë as në kapitullin IV te kësaj kontrate [RREGULLAT E PERGJITHSHME DHE PAGAT], ku në nenin 35 janë paraparë detyrimet për kompensim, ashtu nga pika 4 deri në pikën 10 janë përcaktuar këto obligime financiare te të paditurës: kompensimi për orët shtese, shpenzimet e udhëtimit, shtesa për përvojën e punës, shujta, paga jubilarë e përcjellëse dhe përfshirja e inflacionit në shkallë te pranuar nga enti i Statistikave, por nuk është përfshirë edhe licencimi dhe obligimi i pagesës në shkallë siç është përcaktuar me nenin 7 të kontratës , për çka pretendimet e paditësve për mungesë dhe mos planifikim të buxhetit lidhur me kualifikimin arsimor. Për më tepër, në paragrafin 3 të nenit 35 të kësaj kontrate qartazi përcaktohet se "Pagat e punëtoreve, punonjësve të sistemit të arsimit përcaktohen me aktet ligjore e nënligjore në fuqi. Për ndryshimet dhe shtesat, plotësimet dhe rritjet e mëtejshme të pagave të punonjësve të sistemit të arsimit, punëdhënësi është i detyruar që në procesin e hartimit të buxhetit të çdo viti të konsultohet dhe të marrë mendimin e SBASHK-ut, nënshkruese e kësaj Kontrate Kolektive të Arsimit në Kosovë, përpara se propozimet përkatëse të dorëzohen në Qeveri për miratim.", andaj me rastin e kualifikimit, do të rritet paga bazë e mësimdhënësve në mënyrë automatike, por që lidhur me ndryshimet në pagë të tyre duhet të zbatohen rregullat e sipërcituara, po ashtu edhe po që se në ketë rast do të kishte kjo padi bazë ligjore në bazë të kontratës kolektive të arsimit vitit 2021, kemi të bëjmë më parashkrim në bazë të nenit 352 dhe neni 353 pika 1 e LMD —së, kjo kërkesë padi është e pasafatshme, i Propozojmë Gjykatës Themelore Gjakovë dega Malishevë, të

Refuzoj si të pa bazuar padinë e paditësve sepse, nuk ekziston asnjë bazë ligjore lidhur me këtë raste që ekziston ky detyrim në bazë të kontratës kolektive të vitit 2021.

Me qëllim të vërtetimit të drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, gjykata i shqyrtoi këto provave dhe atë: kontratën e punës nr.11/267 të datës 20.10.2020, Licencën e Mësimdhënësit nr.100024434, diplomën nr.674/17 të datës 07.07.2017 dhe listën e pagës.

Pas vlerësimit të të gjitha provave veç dhe veç dhe në lidhmëni me njëra tjetrën, në kuptim të nenit 8 të LPK-së, gjykata vlerëson se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar, ndërsa e aprovojë pjesërisht për nga lartësia.

Në bazë të provave të sipërpërmendura, gjykata vlerëson se nuk është kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura ndërsa kontestues mes palëve ndërgjyqëse rezulton të jetë e drejta në kompensimin e plotë në emër të licencimit/kualifikimit, andaj nga provat e administruara, si dhe konform dispozitave të Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë të datës 18.04.2021 e lidhur në mes Ministrisë së Arsimit Shkencë dhe Teknologjisë së Republikës së Kosovës dhe SBASHK, sipas nenit 7 paragrafi 1, pika 3 në të cilën përcaktohet se **“Me Licencim fitohet e drejta për punë, avancim në karrierë dhe zhvillim profesional në bazë të legjislacionit të punës në fuqi. Të punësuarve u mundësohet kualifikimi pa shkëputje nga puna sipas legjislacionit të arsimit në fuqi, dhe mbi bazën e kualifikimit dhe mbi bazën e kualifikimit dhe atë: Mësimdhënës me Shkollë të Lartë Pedagogjike dy vjeçare 19% e pagës bazë. Mësimdhënës me diplomë fakulteti tri dhe katër vjeçar 27% e pagës bazë. Mësimdhënës me diplomë 5 vjeçar, magjistraturë/master dhe doktoraturë 35% e pagës bazë”**.

Sipas vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/23 të datës 29.08.2008 në pikën 4 përcaktohet se **“Mësimdhënësit, drejtorët (zëvendës drejtorët) dhe bashkëpunëtorët profesional të pajisur me diplomë të Shkollës Normale përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 10%, me diplomë, me diplomë të shkollës së lartë pedagogjike përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 19%, me diplomë universitare 3 dhe 4 vjet përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 27 % dhe me diplomë të ciklit të dytë dhe të tretë (Magjistraturë dhe Doktoraturë) përfitojnë ngritje të pagës bazë prej 35%”** ndërsa nga Mendimi Juridik i Gjykatës Supreme të nxjerrë nga seanca e përgjithshme i datës 09.10.2023 GJ.A-SU 214/2023 i cili derivon nga vendimi i Qeverisë së Kosovës në pikën I përcaktohet se **“Për kërkesat e mësimdhënësve për kompensimin mbi bazën e kualifikimit (licencimit) kompensimi bëhet sipas kushtëve dhe kritereve të përcaktuara me vendimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr.01/23 të datës 29.08.2008,”** kjo gjykatë vlerëson se mbi bazën e Kontratës Kolektive- Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme dhe Vendimit të Qeverisë së Republikës së Kosovës paditësit i takon e drejta e kompensimit në emër të licencimit/kualifikimit për periudhën 01.02.2021 deri ma datë 06.02.2023 si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, gjykata u bazua në diplomën e kualifikimit të paditësit, licencimin dhe kontratën e punës.

Sipas nenit 8 parag.1 te Ligjit mbi Marrëdhëniet Detyrimeve **“Pjesëmarrësit në raportet e detyrimeve janë të detyruar që ti përmbushin detyrimet e tyre dhe janë përgjegjës për përmbushjen e tyre”** ndërsa në dispozitat e nenit 245 parg.1 të LMD-së, ka paraparë se **“Kreditori në marrëveshjet detyrimeve është i autorizuar që nga debitori të kërkoj përmbushjen e detyrimit e debitori është i detyruar ta përmbush me ndërgjegje këtë në tërësi ashtu si është e paraparë”**, ndërsa në Ligjin e Punës Nr.03/L-212 Gazeta Zyrtare Nr. 90 / 01 Dhjetor 2010 në dispozitat e nenit 90 par.5 lidhur me Marrëveshjen Kolektive përcaktohet se **“Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin përsipër detyrimet e përcaktuara me Marrëveshjen e tillë Kolektive”**.

Meqenëse nga parashtrësia e padisë u konstatua se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura dhe përkundër faktit se e paditura e ka kontestuar padinë dhe kërkesëpadinë e paditëses sa i përket kompensimit në emër të licencimit/kualifikimit, gjithashtu edhe për gjykatën të njëjtat janë të pa kontestueshme, dhe si të tilla janë të besueshme dhe mbi bazën e provave të administruara, konsideron se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit pa shqyrtim të çështjes, në dispozitën e nenit 152 të LPK-së në të cilën është përcaktuar se **“Po që se i padituri me anë të përgjigjes në padi i ka pohuar faktet vendimtare, përkundëjt kontestimit të kërkesëpadisë, gjykata mundet pa caktuar seance gjyqësore, të jep aktgjykim nëse nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e tij”**, ndërsa në nenin 398 është përcaktuar se **“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se ndërmjet palëve nuk është kontestuese gjendja faktike, dhe se nuk ekzistojnë pengesa të tjera për dhënien e vendimit meritor, atëherë ajo, pa caktuar fare seance gjyqësore, mund ta jep aktgjykimin me të cilën e pranon si të themeltë kërkesëpadinë”**, e që në këtë rast e paditura përmes përgjegjës në padi nuk i kontestuar fare faktet vendimtarë dhe as të drejtat e kompensimit në emër të licencimit/kualifikimit, andaj meqenëse në mes palëve ndërgjyqëse nuk ekziston kontest lidhur me faktet relevante, fakte të cilat u vërtetuan edhe nga gjykata me shqyrtimin e provave të cilat gjenden në shkresat e lëndës, gjykata me zbatimin e dispozitave të lartpërmendura vendosi si në dispozitiv të aktgjykimit.

Gjykata shqyrtoi edhe pretendimet e paditurës, por gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase e paditura lidhur me kompensimin në emër të licencimit obligohet në bazë të detyrimeve të cilat dalin nga Kontrata Kolektive, nënshkruese e të cilës është Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, përkatësisht në nenin 2 par.1.1 të kësaj kontrate lidhur me zbatimin e këtyre dispozitave përcaktohet se **“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive, janë të zbatueshme për të gjithë të punësuarit në të gjitha institucionet publike dhe private të Arsimit Parauniversitar (parashkollor, fillor, të mesëm të ultë dhe të mesëm të lartë, shkolla special e qendra të kompetencës) dhe institucionet e arsimit të lartë në mbarë territorin e Republikës së Kosovës, të cilët janë anëtarë të SBASHK-ut”**, ndërsa dispozitat e par.1.2 përcaktohet se **“Dispozitat e kësaj Kontrate Kolektive janë të zbatueshme për të gjithë punëdhënësit në sektorin e Arsimit, (Komunat-DKA, KD të Universiteteve e institucioneve të arsimit të lartë, MASHT-in etj) në sektorin publik dhe institucionet edukativo-arsimore private në mbarë territorin e Republikës së Kosovës”**, sa i përket pretendimeve të të paditurës lidhur me parashkrimin e kërkesës së paditësit, gjykata pretendimet e tilla i konsideroi të pa bazuara ngase paditësi padinë e ka parashtruar në vitin 2023, e poashtu kërkespadia rezulton e kërkuar për të njëjtën periudhë, e që për rrjedhojë në rastin konkret nuk ka parashkrim të kërkesës, dhe

nga kjo gjendje faktike ndërlidhur me dispozitat e Ligjit të Punës Nr.03/L-212, sa i përket kërkesave neni 87 lidhur me afatin e parashkrimit përcaktohën se **“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”**, ndërsa sa i përket pretendimeve për shkëputjen e kontratës kolektive, për gjykatën po ashtu të njëjtat janë të pa bazuara, ngase paditësi sipas padisë kërkonë realizimin e të drejtave gjatë periudhës në të cilën ishte në fuqi Kontrata Kolektive, për çka edhe rrjedhimisht derivojnë të drejtat nga akti juridik i tillë.

Gjykata vendosi si në pikën III të dispozitivit të aktgjykimit duke e refuzuar padinë e paditësit si të pa bazuar të kërkuar në emër të licencimit mbi pagën bazë prej 421.00, ngase bazuar në listën e pagës, gjykata vërtetoi faktin se paditësi pagën bazë rezulton ta ketë 393.00 euro, andaj mbi këtë bazë edhe gjykoi shumat si në dispozitiv, duke u bazuar në këtë gjendje faktike dhe mbështetur në dispozitat e nenit 7.1 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK) është paraparë se **“Palët kanë për detyrë që të paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla”**, ndërsa që me nenin 7.2 të po këtij ligji decidivisht ceket se **“Gjykata është e autorizuar që t’i vërtetoj edhe faktet të cilat palët nuk i kanë paraqitur, si dhe t’i marrë provat të cilat palët nuk i kanë propozuar, vetëm po që se nga rezultati i shqyrtimit dhe i të provuarit del përfundimi se palët kanë për qëllim disponimin me kërkesat me të cilat nuk mund të disponojnë lirisht (të përcaktuar me nenin 3 par.3 të këtij ligji”**, në nenin 399 par. 1 përcaktohet se **“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadiës, atëherë ajo do te jep vendimin meritor me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”**, ndërsa në par. 2 është përcaktuar se **“Kërkesëpadia është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërtënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërtënie me provat të cilat i ka propozuar paditësi, apo me faktet që janë botërisht të ditura”**, andaj duke marr parasysh të gjitha pretendimet e palëve ndërgjygjëse dhe provat e administruara në lidhje me këtë çështje kontestimore, gjykata ka ardhur në përfundim se kërkesëpadia e paditësit është pjesërisht e bazuar.

Gjykata vendosi sikurse në dispozitiv të këtij aktgjykimi duke aprovuar shumën përkatëse të kompensimit duke llogaritur me kamatë ligjore prej 8 % bazuar në nenin 382 par.1 dhe 2 të LMD-së, nga dita e parashtrimit të padisë (07.12.2023), bazuar në Mendimin Juridik për Kamatën të Gjykatës Supreme të Kosovës nr. 265/2020 të datës 02.12.2020, pasi që në rastin konkret pala e paditur është vonuar në përmbushjen e obligimit ndaj palëve paditëse dhe se në këtë rast kemi të bëjmë me dëm material.

Vendimin mbi shpenzimet procedurale gjykata e mori konform nenit 452.2 të LPK-së, dhe Rregullores për tarifat e Avokatëve, duke detyruar të paditurën që paditësit t’ia paguajë dhe atë në emër të parashtrimit të padisë në shumën prej 104.00 euro dhe në emër të taksës gjyqësore shumën prej 20.00 euro.

Me sa u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi në bazë të nenit 152 dhe 398 të LPK-së si dhe nenit 90 paragrafi 5 të Ligjit të Punës lidhur me 35.7 e Kontratës Kolektive Arsimit.

Gjykata Themelore në Gjakovë-Dega në Malishevë
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.890/23 me datën 21.12.2024

Gj y q t a r i
Petrit Curri

Udhëzim juridik: Kundër këtij aktgjykimi, palët kanë të drejtë të parashtrojnë ankesë në afat prej 7 ditësh pas marrjes së të njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, ankesa dërgohet përmes kësaj gjykate.